

## KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin nr.413, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Parkut Sportiv”, Korçë”, botuar në “Fletoren Zyrtare”, nr.101, viti 2016, korrigohet gabimi material, në tabelën e pronarëve të shpronësuar, pasuria me nr.1/750 me sipërfaqe të shpronësuar prej 2350 m<sup>2</sup> dhe pasuria me nr.1/751 me sipërfaqe të shpronësuar prej 300 m<sup>2</sup>, bashkohen në një pasuri të vetme, konkretisht, pasuritë nr.1/750 + 1/751 që do të thotë 2350 m<sup>2</sup> + 300 m<sup>2</sup>, pra në total 2650 m<sup>2</sup>. Vlera e shpronësimit për pasurinë e bashkuar nuk ndryshon.